

Njoftimi i përqendrimit që i referohet krijimit të një sipërmarrjeje të përbashkët plotësisht funksionale ndërmjet Hajneman Afrika GmbH, Gjermani, Xhordanijan Djuti Fri Shops Kompani, Jordani dhe Arab Suplaj & Trejding Co., Mbretëria e Arabisë Saudite

(lënda nr. 08-25, 2024)

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 22.01.2024, te Komisioni i Mbrojtjes së Konkurrencës është dorëzuar një njoftim për përqendrim, që i referohet krijimit të një sipërmarrjeje të përbashkët plotësisht funksionale nga Hajneman Afrika GmbH, Gjermani, me zyrë të regjistruar në Koreashtrase 3, 20457 Hamburg, Gjermani, Xhordanijan Djuti Fri Shops me zyrë të regjistruar në Amon Komplekot, ngjitur me Central Park Hotel, Tunis St. 941601, Aman, 11194, Jordani dhe Arab Suplaj & Trejding Co., me zyrë të regjistruar në 6340 Al Ahsa 3108 Al Zahra Dist. Riad 12812, Mbretëria e Arabisë Saudite e cila do të ofrojë shërbime të shitjes me pakicë të udhëtimit pa doganë dhe do të operojë dyqane të tilla.

- **Hajneman Afrika GmbH**, është një shoqëri e varur e GH. GH është një biznes familjar që operon dhe furnizon dyqane të djuti fri/ dyqane me vlerë gjatë udhëtimit në aeroporte, porte detare, tragete, anije turistike dhe pika kufitare në mbarë botën.

GH ka një prani të regjistruar në Maqedoninë e Veriut dhe ka gjeneruar të ardhura në Maqedoninë e Veriut në vitin 2022 përmes furnizimit me shumicë të mallrave me pakicë gjatë udhëtimit.

- **Xhordanijan Djuti Fri Shops**, është një shoqëri aksionare publike, e themeluar sipas ligjeve të Jordanisë. Xhordanijan Djuti Fri Shops merret me themelimin, menaxhimin dhe investimin në dyqane të djuti fri në pikat kufitare dhe në çdo zonë ku autoritetet lejojnë. Ajo gjithashtu shet mallra të huaja dhe vendase të importuara në monedhë të huaj dhe vendase në dyqane të djuti fri. Asnjë nga dyqanet të djuti fri që operon nga Xhordanijan Djuti Fri Shops XHDFSH nuk ndodhet në aeroportet jordaneze.

- **Arab Suplaj & Trejding Co.** është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas ligjeve të KSA-së. ASTRA merret me punime të përgjithshme ndërtimi të objekteve banesore dhe jo banesore, rrugëve, rrugicave, pranë termocentraleve dhe konvertorëve. Nëpërmjet shoqërisë të varura të saj është nën kontroll të Arab Suplaj & Trejding Co. Grupi është aktiv në bujqësi, prodhim ushqimor, tregti me pakicë dhe shumicë, transport, kujdes shëndetësor, ndërtim, komunikim, konstruksione çeliku dhe materiale ndërtimi, polimere, farmaceutikë, plehra, aktivitete të pasurive të paluajtshme, investime, konstruksion çeliku dhe materiale ndërtimi. Arab Suplaj & Trejding Co. nuk merret me ofrimin e shërbimeve të udhëtimit me pakicë në aeroporte në Vendodhjet e Udhëtimit.

Tregu relevant i mallrave për përqendrimin në fjalë mund të përkufizohet **si shërbime të shitjes me pakicë për udhëtime (shitje me pakicë për udhëtime) në Vendodhjet Udhëtimit.**

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të mbërrijnë në Komision në afat prej 10 ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi.

01.02.2024

Shkup

